REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 693/20
Datë/Datum. 21.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 693/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi – Panelist Individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik: Gani B. Krasniqi B.I. – D.P.Z. "Suzuki" – Miradi e Ulët, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar OE: Ndërmarrja Tregtare Private "Miri" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave të MEA (ish MMPH-së) Loto 1 dhe Loto 2", me nr. të prokurimit: 210-20-3493-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, më datë: 21.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e Grupit të Operatorëve Ekonomik "Gani B. Krasniqi B.I. – D.P.Z. "Suzuki" – Miradi e Ulët, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave të MEA(ish MMPH-së) Loto 1 dhe Loto 2", me nr. të prokurimit: 210-20-3493-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

II.VERTETOHET, njoftimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave të MEA (ish MMPH-së) Loto 1 dhe Loto 2", me nr. të prokurimit: 210-20-3493-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e Grupit të Operatorëve Ekonomik ankues Gani B. Krasniqi B.I. – D.P.Z. "Suzuki" – Miradi e Ulët, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI . Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Grupi i Operatorëve Ekonomik ankues OE Gani B. Krasniqi B.I. – D.P.Z. "Suzuki" – Miradi e Ulët, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 21.09.2020 me nr. 693/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave të MEA(ish MMPH-së) Loto 1 dhe Loto 2", me nr. të prokurimit: 210-20-3493-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues dhe teknik i prokurimit në raportin e dt: 09.10.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Sa i përket pretendimit të OE ankues që këta të fundit kanë dëshmuar se hapësira e objektit -servisit me fletë poseduese me nr.: 14-942-18149 dhe dokumente të tjera përcjellëse përfshin dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi, eksperti gjen pretendimin si pjesërisht të bazuar dhe jep këtë sqarim si në vijim:

-Fillimisht, sqarimi i ofruar nga Autoriteti Kontraktues me datë 06.08.2020 si Kërkesë e informatave shtesë duke specifikuar se dokumentacioni zyrtar kërkuar nga AK është nënkuptuar të jetë "Leje ndërtimore e objektit në fjalë" është ndryshim-plotësim në informatat e publikuara në Dosjen e Tenderit, andaj, AK është dashur t'a përgatis dhe të publikoj Njoftimin për informata shtesë ose përmirësim gabime duke përdorur formularin standard B54. Një interpretim i tillë vjen si rezultat i nenit 25 – "Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore", paragrafit 7 në RRUOPP.

-Dëshmia dokumentare e dërguar nga OE ankues sa i përket pronësisë së objektit përfshin fletën poseduese me numër: 14-942-18149, kopja e planit marrë nga Zyra Kadastrale Komunale: Fushë Kosovë, Certifikata e Tatimpaguesit, Dëshmia nga Departamenti i Tatimit në Pronë nga Komuna e Fushë Kosovës me një sipërfaqe të specifikuar prej 324 m2 dhe Faturat e Tatimit në Pronë të cilat në parim e sipër vërtetojnë kërkesat e paraqitura nga AK në Dosje të Tenderit dhe Njoftim për Kontratë.

-Pas shqyrtimit të përgjigjes ndaj refuzimit së kërkesës për rishqyrtim ofruar nga AK, Eksperti ka dërguar e-mail Agjencisë Kadastrale të Kosovës duke u munduar të vërtetojë që nëse pronësia e objektit me numër 82187819195 me fletë poseduese me numër: 14-942-18149 shtrihet në tërësi të sipërfaqes në parcelat nën pronësi apo nën shfrytëzim të DPZ Suzuki, mirëpo deri në datën e dorëzimit të këtij raporti nuk ka marrë përgjigje. Është fakt i mirëqenë që Agjencia Kadastrale e Kosovës i ka dorëzuar një sqarim Autoritetit Kontraktues sa i përket objektit me numër: 166-0-113-0 ku thuhet që vetëm një sipërfaqe prej 92 m2 shtrihet në parcelën me numër 164-0 ndërsa pjesa tjetër në dy parcela të tjera. Rekomandohet Autoriteti Kontraktues që të vërtetojë përditësimin e vërtetimit të pronësisë së parcelave përgjatë shtrirjes së objektit në fjalë në rivlerësim të lëndës.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave të MEA(ish MMPH-së) Loto 1 dhe Loto 2" me nr. të prokurimit: 210-20-3493-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues rekomandon Panelin Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Grupi i Operatorëve Ekonomik më datë: 12.10.20, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues më datë: 12.10.20, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues duke sqaruar:

Ne si AK, kundërshtojmë vlerësimin e ekspertit që lënda të kthehet në rivlerësim, pasi që ne edhe në letrën standarde të eliminimit si dhe në Kërkesën për Rishqyrtim kemi sqaruar si në vijim:

Komisioni i vlerësimit dhe Autoriteti Kontraktues pas sqarimeve shtesë që u janë kërkuar Operatorit Ekonomik, ka bërë prapë vlerësimin e këtyre dokumenteve shtesë, por kemi ardhur në përfundim që OE në fjalë nuk ka mundur të përmbushë ketë kriter, ashtu siç kemi kërkuar në njoftimin për kontratë si dhe në

dosjen e tenderit dhe me sqarimin e dosjes së tenderit. AK më dt. 07.09.2020, ka kërkuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës informata lidhur me pronësinë e këtij operatori dhe kemi kërkuar që të na jap një përgjigje të saktë lidhur me pronësimin e objektit dhe hapësirën e OE Gani B. Krasniqi B.I. MIRADI E ULËT, MIRADI E ULËT- FUSHE KOSOVË.

Agjencioni Kadastral i Kosovës me dt. 09.09.2020, ka kthyer përgjigje dhe ka dëshmuar përmes fotos të cilën e gjeni të bashkëngjitur dhe metrave të sakta të cilat janë brenda parcelës së OE, e që janë sipas Agjencionit Kadastral vetëm 92m2:

"I nderuar,

Objektin me nr. 166-0-113-0 shtrihet në parcelën nr. 164-0 vetëm s=92m2, pjesa tjetër e objektit shtrihet në parcelën 166-0 dhe parcelën me nr. 512-0 që nuk janë pronë e Operatorit Ekonomik, por janë pronë shtetërore, andaj si e tillë ne si AK nuk mund të rrezikojmë dhe të japim kontrata për 36 muaj për Operatorët të cilët ende nuk kanë të zgjidhur pronësinë e tyre dhe në çdo moment mund edhe të mos jete ai objekt funksional.

Gjithashtu, ju lutem që edhe ju si Panel të ju drejtoheni Agjencionit Kadastral dhe të bëni vërtetësinë e këtyre sqarimeve dhe dëshmive, si dhe lënda të mos kthehet ne rivlerësim, pasi që AK i ka shterur të gjitha mundësitë përmes sqarimeve dhe ka bërë vlerësimin e drejtë në bazë të LPP-së.



Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 21.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit

të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Sa i përket pretendimit të OE ankues që këta të fundit kanë dëshmuar se hapësira e objektit -servisit me fletë poseduese me nr.: 14-942-18149 dhe dokumente të tjera përcjellëse përfshin dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi, Paneli shqyrtues sqaron se dëshmia dokumentare e dërguar nga OE ankues sa i përket pronësisë së objektit përfshin fletën poseduese me numër: 14-942-18149, kopja e planit marrë nga Zyra Kadastrale Komunale: Fushë Kosovë, Certifikata e Tatimpaguesit, Dëshmia nga Departamenti i Tatimit në Pronë nga Komuna e Fushë Kosovës me një sipërfaqe të specifikuar prej 324 m2 dhe Faturat e Tatimit në Pronë.

Paneli shqyrtues sqaron se AK me email-in e datës 12 tetor 2020 ka sqaruar se Komisioni i vlerësimit dhe Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik dhe ka bere prape vlerësimin e këtyre dokumenteve shtese, me rast edhe ka konstatuar se OE nuk e përmbush kriterin kërkuar në dosje të tenderit. AK me dt. 07.09.2020, ka kërkuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës informata lidhur me pronësinë për objektin dhe hapësirën numër 82187819195 me fletë poseduese me numër: 14-942-18149 të OE DPZ Suzuki.

Agjencioni Kadastral i Kosovës me td. 09.09.2020, ka kthyer përgjigje dhe ka dëshmuar metrat e sakta te cilat janë brenda parcelës se OE, e qe janë sipas Agjencionit Kadastral vetëm 92m2, citat i përgjigjes së Agjencionit: "Objektin me nr. 166-0-113-0 shtrihet në parcelën nr 164-0 vetëm s=92m2 pjesa tjetër e objekti shtrihet ne parcelën 166-0 dhe parcelën me nr 512-0 qe nuk janë prone e Operatorit Ekonomik, por janë prone shtetërore, andaj si e tillë ne si AK nuk mund te rrezikojmë dhe te japim kontrata për 36 muaj për Operatoret te cilët ende nuk kane te zgjidhur pronësinë e tyre dhe ne çdo moment mund edhe te mos jete ai Objekt funksional" mbarim citati.

Paneli shqyrtues vlerëson se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit AK ka vepruar konform dispozitave të LPP-së më saktësisht ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform dispozitave të nenit 59 të LPP-së, pasi që OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues vlerëson se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Poashtu, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

1x1 Grupi i OE – Gani B. Krasniqi B.I. – D.P.Z. "Suzuki" – Miradi e Ulët

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.